

LIGJ
Nr.8392, datë 2.9.1998

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993 "PËR
SIGURIMET SHOQËRORE NE REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME
LIGJIN NR.7932, DATË 17.5.1995 DHE ME LIGJIN NR.8286, DATË 16.2.1998**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995 dhe nr.8286, datë 16.2.1998 bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në nenin 12 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Punëdhënësit privatë mund të sigurohen vullnetarisht deri në dyfishin e pensionit minimal të pleqërisë, pensionit të invaliditetit dhe atij familjar."

Neni 2

Në nenin 15 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Akti që përmban detyrimin për pagesën e kontributeve përbën titull ekzekutiv."

Neni 3

Në nenin 16, pika 3, fjalët "nga 5000 deri 10 000 lekë", zëvendësohen me fjalët "nga 6000 deri në 60 000 lekë".

Neni 4

Në nenin 18 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Për kontributet e paderdhura, nga subjektet brenda afatit, organet e sigurimeve shoqërore kanë të drejtën të nxjerrin aktdetyrimi, i cili është titull ekzekutiv."

Neni 5

Në nenin 29, pika 2, fjalët "me 1500 lekë" zëvendësohen me fjalët "50 për qind të pagës minimale mujore".

Neni 6

Në nenin 52, pika 4, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Në rastet kur përfitues i pensionit familjar është vetëm një jetim, shuma e pensionit familjar është 50 për qind e pensionit të plotë, që merrte ose do të merrte personi që ka vdekur".

Neni 7

Në nenin 58, pika 1, në fund të shkronjës "b" shtohen fjalët:

"përfshirë edhe periudhën e përfitimit të pensionit të pjesshëm të invaliditetit."

Neni 8

Në nenin 62 bëhen këto ndryshime:

- Pika 2 ndryshohet si vijon:

"2. E drejta e pensionit nuk parashkruhet.

Personit, i cili kërkon pensionin jo më vonë se 1 vit nga data që i lind kjo e drejtë, ky pension i paguhet që nga kjo ditë. Në raste të tjera pensioni do të paguhet nga data e paraqitjes së kërkesës për pension.

E drejta për të ardhurat e tjera parashkruhet me kalimin e një viti nga data e fillimit të së drejtës për përfitimin e tyre."

- Pika 3 ndryshohet si vijon:

"3. Pensionet e njohura, por të patërhequra do të paguhen në çdo kohë, por jo më shumë se për 3 vjet.

Pensionet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë, por jo më shumë se për tre vjet.

E drejta për të kërkuar shumat e marra tepër gjatë një viti, ushtrohet jo më vonë se 3 vjet nga marrja e tyre, por jo më vonë se 6 muaj nga data e konstatimit.

Personi që ka përfituar të ardhura në mënyrë e mjete të padrejta, si edhe kur nuk njofton ndryshimin ose heqjen e masës së tyre, detyrohet të kthejë të gjithë shumën e marrë tepër."

Neni 9

Në nenin 68, pika 2, në fund të paragrafit të parë shtohen fjalët: "me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë miratohet në buxhetin vjetor të sigurimeve shoqërore".

Neni 10

Në nenin 76, pika 4, fjala "në rrethe", zëvendësohet me fjalën "rajonale".

Neni 11

Në nenin 91, pika 4 bëhen këto ndryshime:

- Pas fjalëve "1 shtator 2000 e në vazhdim", shtohen fjalët "pavarësisht nga vendi dhe vitet se kur janë kryer studimet".

- Në fund të pikës 4 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: "Në këtë rast kontributet përballohen nga buxheti i shtetit në kohën kur paraqitet kërkesa për pension."

Neni 12

Neni 96 ndryshohet si vijon:

"Personat që periudhën e sigurimit e kanë duke pas qenë pjesërisht në marrëdhënie pune në ish-kooperativat bujqësore dhe pjesërisht në marrëdhënie me shtetin, kanë të drejtën të përfitojnë pension sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", me gjithë ndryshimet e mëvonshme të tij, në qoftë se periudha e sigurimit do të jetë në marrëdhënie me shtetin:

- Për pensionet e pleqërisë jo më pak se gjysma e asaj që përcaktohet në nenin 92.

- Për pensionet e invaliditetit ose pension familjar jo më pak se gjysma e asaj që parashikon ligji nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

Në rastet e tjera, pensioni mujor i pleqërisë do të përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë. Shuma bazë caktohet nga Këshilli i Ministrave, ndërsa shtesa që u jepet këtyre personave, do të jetë 1 për qind për çdo vit sigurimi, nga data 1.10.1993 e në vazhdim, shumëzuar me bazën mesatare të vlersueshme që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve.

Të vetëpunësuarit në bujqësi, që plotësojnë kushtet për pension pas hyrjes në fuqi të kësaj

dispozite, mund të njohin periudha të kaluara si periudha sigurimi kundrejt pagesës së kontributeve për vitet përkatëse, në atë masë që është caktuar nga Këshilli i Ministrave, por jo për periudhat para datës 1.10.1993. Këtë të drejtë ata e ushtrojnë deri në një vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Konditat e përfitimit për pensionet janë ato të përcaktuara në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

Koha e sigurimit, për të cilën është derdhur kontribut pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", për efekt të kësaj dispozite njihet vjetërsi pune në marrëdhëniet me shtetin."

Neni 13

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2211, datë 15.9.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani